



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronjat c) d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, dhe nenit 64 paragrafët 3 dhe 4, ndërlidhur me nenet 14, 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 - 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, miratoi këtë,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

- *Propozim Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Hakif Zejnullahu" në Podujevë*

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **09 maj 2022 deri më 09 qershor 2022**, brenda së cilës Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit mund të organizoj diskutime të ndryshme, kurse Debatit publik me qytetarë mbahet më **18 maj 2022** duke filluar nga **ora 10:00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; jakup.gashi@rks-gov.net të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik)

Neni 5

Diskutimi/debatit publik zbatohet nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debatit publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimi ose mospranimi të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-016/01-0030702/22
Podujevë, datë, 29 prill 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Kuvendi Komunal Podujevë / Skupština Opštine Podujevo / Municipality Assembly Podujeva

PROPOZIM

RREGULLORE
PËR MËNYREN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË
PALESTRËS SPORTIVE “HAKIF ZEJNULLAHU” NË
PODUJEVË

Podujevë
Mars 2022

1

Kuvendi Komunal i Podujevës |

Në bazë të nenit 10 dhe 12, paragrafit 2 dhe shkronjes c) si dhe nenit 40, paragrafit 2 dhe shkronjes a) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, neni 85, pika 2 e Statutit të Komunes së Podujevës Nr.1-34 e datës .././2021 si dhe nenit 1.3 dhe 1.4 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit e Akteve të Komunës, Kuvendi i komunes së Podujevës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. _____ 2021 miratoi këtë rregullore:

Në bazë të nenit 62 paragrafët 2 dhe 3, ndërlidhur me nenet 11, 12.2 shkronja c), 17 shkronja s) dhe nenin 40.2 shkronja a) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit e akteve të komunës, dhe në pajtim me nenet 64 paragrafët 3 dhe 4, ndërlidhur me nenet 14, 15 paragrafi 2.3 dhe nenin 19 paragrafi 1.19 të Statutit të Komunes së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendit të Komunës së Podujevës i;

Propozon

**RREGULLORE
PËR MËNYREN DHE KUSHTET E SHFRYTZIMIT TË
PALESTRËS SPORTIVE “HAKIF ZEJNULLAHU” NË PODUJEVË**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve, aktiviteteve sportive të klubeve të regjistruara në Federatat gjegjëse, manifestimeve të ndryshme të kulturës, tubimeve partiake, revistave, rekreacionit si dhe grupeve të tjera joformale.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. **DKRS** – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. **Objektet Sportive** – Nënkupton objektin ku ndodhen zveshtoret, byfeja, hapësirat teknike dhe logjistike, fusha sportive me të gjitha pajisjet tjera mbështetëse.

**Neni 3
Funksionimi i objekteve sportive**

1. Funksioni primar i objekteve sportive është që të ofroj kushte për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative, koncerteve, tubimeve dhe ngjarje tjera të organizuara.

2

Kuvendi Komunal i Podujevës |

2. Në palestër mund të zhvillohen ndeshje dhe stërvitje të cilat janë të përshtatshme vetëm për ambiente të mbyllura si: Basketboll, Henboll, Volejball, Futsall dhe sporte tjera të licencuara.
3. Në palestër mund të zhvillohen aktivite të tjera sportive të cilat vlerësohen si jo të rrezikshme për dëmtimin e dyshemes dhe të ambienteve tjera, në të cilat përdoren pajisje që nuk e dëmtojnë dyshemenë dhe infrastrukturën e palestrës.
4. Në palestër mund të zhvillohen aktivitetet promovuese dhe tubime nga fushata politike, përmes kërkesës së paraqitur në DKRS.

Neni 4

E drejta për shfrytëzimin e palestrës sportive

Të drejtë shfrytëzimi të palestrës sportive kanë: instucionet shtetërore, klubet sportive, organizatat politike, organizatat joqeveritare, bizneset, instucionet shkollore, universitetet, instucionet ndërkombëtare si dhe grupet e tjera formale dhe joformale.

Neni 5

Mënyra e shfrytëzimit të Palestrës sportive

Mënyra e shfrytëzimit të palestrës sportive rregullohet me anë të kërkesës të palës së interesuar, drejtuar Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 6

Kërkesa për shfrytëzim

1. Pala e interesuar për shfrytëzim të palestrës duhet të paraqes kërkesë së paku 3 (tri) ditë para mbajtjes së aktivitetit.
2. Kërkesa i drejtohet me shkrim DKRS-së, e cila obligohet për t'i kthyer përgjigje me shkrim brenda 24 orëve.
3. Klubet sportive të komunës së Podujevës të cilat janë të licencuara në Federatën gjegjëse dhe që e kanë kalendarin e rregullt të garimeve nuk i nënshtrohen paragrafit 2.

Neni 7

Rregullat themelore për shfrytëzimin e objekteve sportive (rendi shtëpiak)

1. Për pakënaqësitë eventuale, shfrytëzuesi duhet t'i drejtohet me ankesë DKRS-së.
2. Menaxheri i palestrës në koordinim me DKRS, ka të drejtë ta suspendoj përkohësisht shfrytëzuesin e sallës për mos respektimin e kriterëve të përcaktuara në marrëveshje dhe rregullave sipas dispozitave të kësaj rregulloreje deri në vendimin tjetër të DKRS-së.
3. Shfrytëzuesi i palestrës duhet të identifikohet dhe të regjistrohet çdo herë para shfrytëzimit të palestrës dhe ta respektoj orarin e caktuar në marrëveshje me personat përgjegjës të palestrës.
4. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha hapsirat brenda palestrës.
5. Pas shfrytëzimit të hapësirave në palestër dhe zhveshtoreve, kujdestarët kontrollojnë hapësirat për të verifikuar gjendjen.
6. Klubet dhe individët duhet të kujdesen për gjërat e tyre personale. Menaxhmenti në palestër nuk mban përgjegjësi për gjërat e humbura apo dëmtuara.
7. Shfrytëzimi i palestrës bëhet me pagesë sipas tarifës së caktuar me këtë rregullore, përjashtim bëjnë vetëm subjektet e lira.
8. Pajisjet që përdoren në palestër nga sportistët duhet të jenë të përshtatshme me ambientin e palestrës. Përjashtohet rasti kur ka ndonjë marrëveshje të posaçme me DKRS-në.

9. Ndalohet hyrja në parket me këpucë të papastra që lënë gjurmë.
10. Shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektin sportiv është e ndaluar.
11. Klubet sportive duhet të sjellin orarin e tyre për shfrytëzimin e palestrës te menaxheri i palestrës.
12. Fëmijet nën moshën 16 vjeçare duhet të jenë nën përcjellje të prindit apo kujdestarit të tyre.
13. Ndalohet hyrja me kafshë në palestër, përjashtim rasti kur kafsha i ndihmon personit me aftësi të kufizuara.
14. Në zhveshtore nuk lejohet asnjë lloj i pijeve alkolike, pijeve me ambalazh qelqi, ndërsa lejohen pijet freskuese të lojës.
15. Ndalohet hyrja në palestër me bicikleta, skatebord apo çfardo mjete tjetër transportues, përjashtimisht personat me aftësi të kufizuara.
16. Ndalohet hyrja me armë, përjashtim bëhet vetëm për personat e autorizuar të sigurisë në detyrë.
17. Ndalohet vendosja e posterëve dhe njoftimeve tjera, pa leje me shkrim nga ana e menaxherit të palestrës dhe DKRS.

Neni 8

Vendosja e reklamave

1. Tarifat për vendosjen e reklamave për caktohen në bazë të Rregullores së Komunës së Podujevës për Taksa, Tarifa dhe Gjoha.
2. Kohëzgjatja e vendosjes së reklamave në vendet e zgjedhura do të jetë deri një vit, me të drejtë vazhdimi sipas kontratës së re.
3. Vendi i vendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes me DKRS.
4. Shpenzimet e shkrimit, vendosjes dhe zhvendosjes së reklamës i bartë subjekti i cili ka vendosur reklamën.
5. Pagesa për reklamën e ekspozuar bëhet çdo muaj dhe atë në fillim nga data 1 – 5 muajit vijues, në gjirrollogarinë e Komunës së Podujevës.
6. Në palestrën sportive, klubet mund të ekspozojnë reklamat lëvizëse të sponsorëve të tyre vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre, por me kusht që mos të pengohen reklamat egzistuese në palestër.
7. Në rastet ku paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklamë në të njëjtin vend, përzgjedhja bëhet me licitacion. – (në këtë rast ka kuptimin kush ofron më shumë mjete buxhetore për të njëjtën gjë)
8. Palët që vendosin reklamat janë përgjegjëse për dëmet eventuale që shkaktohen gjatë vendosjes dhe heqjes së tyre dhe obligohen që t'i marrin përsipër të gjitha shpenzimet për riparimin e nevojshëm.

Neni 9

Dokumentacioni i nevojshëm për shfrytëzimin e palestrës

1. Klubet e interesuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të rregullta sportive duhet t'i sjellin tek Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit këto dokumente:
 - 1.1. Çertifikatën e regjistrimit,
 - 1.2. Çertifikatën fiskale,
 - 1.3. Lejën e njoftimit të personit përgjegjës,
 - 1.4. Listën e antarëve (lojtarëve), të klubit.
2. Klubet e regjistruara dhe DKRS pas shqyrtimit të kërkesës së klubit lidhin marrëveshje për shfrytëzimin e palestrës.

3. Subjektet tjera që nuk janë klube sportive të regjistruara, për shfrytëzimin e palestrës sportive duhet ta paraqesin kërkesën për shfrytëzim pranë DKRS.

Neni 10

Pagesa për shfrytëzimin e objekteve në palestër

1. Të gjitha klubet që janë të regjistruara në DKRS, respektivisht që janë të licensuara nga Federatat gjegjëse apo garojnë në kuadër të Federatave përkatëse e që janë nga Komuna e Podujevës mund ta shfrytëzojnë palestrën për stërvitje dhe gara në bazë të një orari të rregulluar nga përgjegjësi i palestrës në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre klubeve dhe të aprovuara nga DKRS. Tarifat dhe pagesat rregullohen bazuar në Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha të Komunës së Podujevës.

Neni 11

Masat ndëshkuese

1. Ndaj palëve të cilat nuk e respektojnë rendin shtëpiak dhe rregulloren, do të merren masat ndëshkuese, suspendim i përkohshëm nga e drejta e shfrytëzimit të palestrës me kohëzgjatje deri në një(1) muaj dhe nëse përsëritet më shumë se dy herë i njëjti veprim atëherë i merret e drejta për shfrytëzim.
2. Për dëmtimet eventuale të shkaktuara nga klubet apo subjektet tjera përkatëse përgjegjësia bie te shfrytëzuesi i cili e ka shkaktuar dëmin, andaj kompenzimet duhet bërë në afat prej pesë (5) ditëve në xhirollogarinë e komunës së Podujevës.
3. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni "ad-hoc" prej tre anëtarëve të emëruar nga DKRS. Në rast të moskompenzimit të dëmeve në afatin e paraparë sipas paragrafit 2 të këtij neni, inciohet procedura gjyqësore përmes përmbaruesit privat duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe ndalesën për shfrytëzim deri në zgjidhjen e kontestit.

II. Dispozitat Kalimtare

Neni 12

Zbatimi i Rregullorës

Zbatimin e kësaj Rregulloreje, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit -

Neni 13

Hyrja në fuqi

Pas miratimit final, kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit të rregullores në ëeb-in zyrtar të komunës së Podujevës.

Nr.prot. _____
Podujevë,
_____ 2022

Drejtori
Pajtim Balaj

5

Kuvendi Komunal i Podujevës